



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 36
Prishtinë, më 27 tetor 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 27 TETOR 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmuan **Xhavit HALITI** dhe **Sabri HAMITI**, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me pikën e vetme të

R e n d i t ë d i t ë s

- 1. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”**

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka parashtruar kërkesë për Interpelancë të kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, lidhur me situatën politike dhe atë të sigurisë në pjesën veriore të Kosovës.

Ai, më tej i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e Interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar, në bazë të vendeve që kanë në Kuvend dhe për deputetët pa grup parlamentar, e cila është përcaktuar në bazë të Rregullores së Kuvendit.

Kryetari ftoi propozuesin e Interpelancës ta marrë fjalën.

Deputeti **Glauk Konjufca**, tha se të gjithë ata që e kanë përkrahur aksionin e 25 korrikut 2011 të Qeverisë së Kosovës, për ta shtrirë sovranitetin në veri të vendit, menduan se Qeveria më në fund ishte e vendosur për një gjë të tillë. Mirëpo, në tre muajt e fundit u pa se kjo gjë ishte bërë për negociata me Serbinë, ngase pikat doganore mbetën të pambrojtura pas tërheqjes së menjëhershme të forcave të Policisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe se ato pika u gjendën nën sulmin e bandave kriminale serbe, të ndihmuara nga Beogradi.

Pas pavarësisë së Kosovës është hera e dytë që digjen pikat doganore të Republikës së Kosovës, herën e parë më 18 shkurt 2008, dhe herën e dytë, më 26 korrik 2011, konstatoi deputeti Konjufca.

Më tutje, ai u fokusua në barrikadat e vendosura në pjesën veriore të vendit dhe pamundësinë e lëvizjes së lirë në atë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, deputeti Konjufca parashtrroi një mori pyetjesh drejtuar kryeministrit të Kosovës, të cilat kanë të bëjnë me: tërheqjen e Policisë Speciale të Kosovës nga pikat doganore në veri të vendit një ditë pas aksionit të 25 korrikut 2011, planin e Qeverisë për deblokimin e kësaj pjese të vendit, sa janë të mbrojtur mbi 4000 qytetarë shqiptarë që jetojnë në atë pjesë, a ka ekzistuar ndonjëherë marrëveshje e shkruar për atë pjesë të territorit të Kosovës, a ka ndonjë vijë të kuqe lidhur me këtë pjesë të Kosovës dhe kush e ka bërë atë dhe kush me kënd është marrë vesh?

Kryeministri **Hashim Thaçi**, fillimisht tha se e mirëpresim kërkesën për këtë interpelancë, në mënyrë që të forcohet uniteti i tërë spektrit politik, pozitë – opozitë.

Në vazhdim, kryeministri Thaçi çështjen e shtrirjes së autoritetit të institucioneve të Kosovës dhe sundimin e rendit dhe të ligjit në tërë territorin e Kosovës e vlerësoi si çështje mbi çështje.

Më tej, kryeministri tha se situata në veri të Kosovës është trashëguar që nga përfundimi i luftës në Kosovë dhe se UNMIK-u gjatë kohës së administrimit të Kosovës ka dështuar për ta vendosur rendin dhe ligjin në atë pjesë të Kosovës, gjë që në mënyrë direkte ose indirekte ka cenuar tërësinë territoriale të Kosovës. Sot nuk dua të fajësoj Qeveritë e kaluara për mos vendosjen e rendit dhe të ligjit në këtë pjesë, por dua të them se gjendja e akumuluar me vite të tëra në atë pjesë ka nxitur reagimin e bandave kriminale serbe për kaos në atë pjesë të territorit të Kosovës, theksoi kryeministri.

Duke paraqitur qëndrimin e Qeverisë së Kosovës rreth gjendjes në veri të vendit, kryeministri Thaçi gjendjen në veri e kategorizoi në tri periudha: periudha e parë pas çlirimit të Kosovës deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës, në vitin 2008, periudha e

dytë, nga 17 shkurti 2008, deri më 25 korrik 2011, dhe periudha e tretë, nga 25 korrik 2011 e tutje.

Aksionin e 25 korrikut 2011, kryeministri e vlerësoi si kthesë vendimtare në drejtim të shtrirjes së institucioneve të Kosovës në tërë territorin e saj dhe një nga vendimet jo të lehta, por të drejtë dhe të domosdoshëm dhe në koordinim të plotë me institucionet shtetërore të sigurisë dhe ato ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Më pas kryeministri u fokusua në arsyet e marrjes së vendimit të 25 korrikut 2011 dhe në masat e reciprocitetit që zbatoi Qeveria e Kosovës, në raport me prodhimet që vijnë nga Serbia.

Kryeministri një pjesë të fjalës së tij ia kushtoi edhe investimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në pjesën veriore të vendit.

Në fund, kryeministri Thaçi konstatoi se masat e ndërmarra nga Qeveria nuk janë të drejtuara kundër asnjë qytetari të Kosovës, pa dallim etnie, fundi i strukturave paralele serbe në Kosovë nuk është i largët dhe nuk do të ketë trajtim të veçantë për asnjë pjesë të territorit të Kosovës, por do të ketë sundim të rendit dhe të ligjit në tërë territorin e saj.

Në këtë drejtim, tha ai, kemi përkrahjen e shteteve dhe të organizatave të botës demokratike si: SHBA-së, BE-së, NATO-s etj.

Kryetari hapi diskutimin lidhur me Interpelancën e kryeministrit Hashim Thaçi.

Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se mbështesim qëndrimet dhe veprimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me gjendjen në veriun e vendit. Ky problem, tha ai, është i krijuar që nga paslufta e deri më tani dhe si të tillë do ta zgjidhim në bashkëpunim me KFOR-in dhe forcat tjera ndërkombëtare, dhe se duhet t'iu gëzohemi sukseseve të KFOR-it në Kosovë.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se vrasjen e policit të Kosovës, gjatë aksionit të 25 korrikut 2011, e kemi përjetuar rëndë. Për ne mbetet shqetësim djegia e pikave doganore, shkatërrimi i pronës dhe mos sundimi i rendit dhe i ligjit në atë pjesë të Kosovës. Strukturat paralele serbe në atë pjesë të vendit duhet shkatërruar sa më parë, tha deputeti Beqiri.

Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, tha se në këtë Kuvend po bëhet thirrje për unitet, por duhet të thuhet se për çfarë uniteti është fjala; unitet për mbajtjen e pikave doganore jashtë funksionit, unitet për vazhdimin e gjendjes ekzistuese në atë pjesë të Kosovës, apo unitet për diçka tjetër.

Më tutje, deputeti Kurti u fokusua në çështjen e dialogut Kosovë-Serbi, duke thënë se marrëveshjet e arritura në Bruksel nuk po zbatohen nga ana e palës serbe dhe se pa vendosjen e kushteve nga bashkësia ndërkombëtare për Serbinë, çështja e dialogut do të jetë e pavlerë dhe do të jetë një Serbi e pandryshuar.

Deputeti Kurti theksoi edhe një mori pikash të cilat duhet t'i përmbush shteti serb para dialogut me Kosovën, disa nga të cilat janë: Serbia t'a njoh pavarësinë e Kosovës, Serbia t'i kërkojë falje Kosovës për veprimet e shkaktuara në shekullin XIX dhe XX, ndërprerjen e funksionimit të strukturave paralele serbe në Kosovë etj.

Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se për veriun e Kosovës do të flasim së paku edhe një kohë, sepse kjo Qeveri nuk është e përgatitur për t'a zgjidhur këtë çështje, pasi që nuk ka plan për diçka të tillë.

Në vazhdim, tha se grupi parlamentar që ai përfaqëson, ka përkrahur aksionin e 25 korrikut 2011 në atë pjesë të vendit, por pak ditë më vonë kemi tërhequr vëmendjen se veprimet gjysmake të Qeverisë dëmtojnë vetë institucionet e vendit.

Më pas, ai e kritikoi Qeverinë, siç tha, për dështimin e zbatimit të strategjisë për veriun dhe propozoi disa masa për tejkalimin e kësaj gjendjeje, siç janë: formimi i grupit ndërministror për veriun, krijimi i një fondi të veçantë, shtimi i nivelit të shërbimeve nga ana e Qeverisë, përmirësimi i infrastrukturës rrugore etj.

Këto veprime duhet të bëhen në bashkëpunim me SHBA-në, NATO-n etj., theksoi deputeti Ramadani.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se bllokimit të rrugëve në këtë pjesë të vendit duhet t'i jepet fund.

Ajo më tej shprehu bindjen se roli i misionëve ndërkombëtare në atë pjesë duhet të rritet në kuptim të sundimit të rendit dhe të ligjit, ndërsa roli i Qeverisë së Kosovës duhet të mos mbetet në pozita inferioriteti. Në fund, deputetja Selmani potencoi se Plani i Presidentit Ahtisari është zgjidhja më e mirë dhe e pranueshme në këto rrethana, përtej të cilit nuk mund të kalohet.

Petar Miletij, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se problemet në veri të Kosovës nuk mund të zgjidhen me një lëvizje. Sipas tij, për zgjidhjen e këtij problemi duhet të kyçen katër faktorë: Prishtina zyrtare, Beogradi zyrtar, bashkësia ndërkombëtare dhe popullata vendore dhe se me një bashkëpunim të mirë të këtyre faktorëve, kjo gjë mund të arrihet.

Më tej, ai theksoi se kur flitet për pjesën veriore të Kosovës, nuk është mirë që të kriminalizohet e tërë popullata serbe e cila jeton në këtë pjesë të vendit.

Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar "6+", në mes tjerash tha se zgjidhja e problemit të veriut nuk është çështje vetëm e Qeverisë së Kosovës, por edhe e faktorit ndërkombëtar.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë çështje dhanë edhe këta deputetë: **Shaip Muja, Burim Ramadani, Bekim Haxhiu, Sabri Hamiti, Rexhep Selimi, Ardian Gjini, Muhamet Mustafa, Agim Kuleta, Hydajet Hyseni, Sadri Ferati, Alma Lama, Donika Kadaj-Bujupi, kryeministri Hashim Thaçi, Emin Gërbeshi, Vjosa Osmani, Visar Ymeri, Ahmet Isufi, Idriz Vehapi, Anton Quni, Zenun Pajaziti, Ramiz Lladrovci dhe Niazi Idrizi.**

Diskutimet e plota të përfaqësuesve të grupeve parlamentare dhe të deputetëve janë dhënë në transkript, që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në përfundim të këtyre diskutimeve, kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, dha sqarime dhe paraqiti qëndrimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me situatën politike dhe atë të sigurisë në pjesën veriore të Kosovës.

Në fund, në emër të propozuesit të Interpelancës, deputeti Glauk Konjufca paraqiti tekstin e mocionit:

1. Të ndërpriten bisedimet me Serbinë dhe të shpallen të pa vlefshme dhe të pa zbatueshme secila marrëveshje me Serbinë, përderisa ajo nuk e njeh Kosovën dhe rregullimin e brendshëm të saj,
2. Qeveria t'i dërgojë forcat policore në veri për të garantuar integritetin territorial dhe mbrojtjen e qytetarëve të shtetit të Kosovës,
3. Institucionet e rendit të Republikës së Kosovës të angazhohen në heqjen e barrikadave dhe të pengesave të tjera për qytetarët, dhe
4. Qeveria t'ua presë burimet financiare strukturave të paligjshme dhe kriminale të shtetit të Serbisë, t'i arrestojë krerët e tyre, si dhe t'i shpërbëjë ato.

Kryetari hodhi në votim mocionin e lëvizjes “Vetëvendosje”. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	17,
Kundër-----	70,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi mocionin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 13:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale